



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
AGENCY AGAINST CORRUPTION AGENCY

D.P
01

Nr. Prot. 03-27 20/11
Data 13.05-2011



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË /OPSTINSKI SUD ZA PREKRSAJE U PRISTINI/MUNICIPAL OFFENCES COURT IN PRISTINA

Nr.regj. 16940/2010

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Miradije Mavriqi nga Prishtina. për kundërvajtje nga neni 6 parag.2 lidhur me nenit 16 parag.1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, e ne bazë të nenit 73,74,195 dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, merr këtë:

A K T V E N D I M

E PANDEHURA: Miradije Ahmet Mavriqi e lindur më 1954 në Prishtinë ku dhe tani jeton rr."UÇK-së" hyr.C nr.11,e martuar nënë e tre fëmijëve,kryesuese e zyres për regjistrimin e partive politike pranë KQZ-së,

E s h t ë p ë r g j e g j ë s e

Sepse si Kryesuese e Zyres për regjistrimin e partive politike në KQZ,nuk e ka bërë deklarin e pasurisë pranë Agjensisë Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor edhe pse ka qenë e përfshirë në listen e Zyrtarëve të Lartë Publik të Komisionit Qëndror Zgjedhor të cilët kanë qenë të obliguar të dekalrojnë pasurinë. Me veprim të këtyllë ka kryer kundërvajtje të nga neni 6 parag.2 lidhur me nenin 16 parag.1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik, andaj për këtë.

G J O B I T E T

Me gjobë ne shumë prej 1000(njëmijë) €, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së. Nr.1000 4300 7000 0518. Pagesa bëhet në ndonjë agjensi për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës të plotësuar nga Gjykata.Nese gjobën e shqiptuar nuk e paguan ne afatin e dhenë e njëjta do ti zavendsohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur, kurse ne emër të paushallit gjyqsor e pandehura është e obliguar të paguaj shumën prej 5 €, në shërbimin e arkës së Gjykatës.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë parashtroj gjykatës kërkesën nr.01/2287/2010 më dt.15.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurës Miradije Mavriqi dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pas marrjes së kërkesës,gjyqtari e filloi procedurën dhe e mori në pyetje të pandehurën e përmendur më lartë e cila në mbrojtjen e vet e pranoi se nuk e ka bërë deklarin e pasurisë pranë AKK duke menduar se nuk është në pozicionin e personit i cili nënshkruan diçka për të përfituar në mënyrë të kundërligjshme,andaj nuk e ka plotësuar dhe dorëzuar formularin mbi deklarin e pasurisë.

Nga të dhënat e parashtruara në kërkesë deklarata e të pandehurës si dhe nga shiqimi dhe vlerësimi I shkresave tjera të deponuara në lëndë,Gjykata konstatoi se e njëjta e ka kryer kundërvajtjen ashtu siq e rëndon kërkesa,për çka u shpall e fajshme dhe në vështrim të nenit 16 parag.1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik,u gjobit me gjobë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktvendimi ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës se marrjes së ketij aktvendimi nepërmes të kësaj Gjykate dhe pa taksa.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,

Me dt. 03.03.2011

KRYETARI I GJYKATËS

Mustafë Selimi